



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data 15.01.17	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	104-1812	1.

Republika e Kosovës, Komuna e Kaçanikut, në bazë të nenit 2, nenit 3, par 1. 3, nenit 8 të Ligjit numër 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2 par 4, nenit 4, 6, 7, 9 të Rregullorës së Qeverisë së Kosovës Nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke u bazuar në Vendimin Paraprak për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatshkurtër me numër 01.16 – 6419 të datës 15.02.2016, si dhe Vendimit me numër 01Nr. 16-19570/15 për formimin e Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim, Komisioni në mbledhjen e mbajtur më datë 13.01.2017, vendos për shpalljen:

ANKAND PUBLIK

Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

I. Ipen në shfrytëzim afatshkurtër prej 15 vite, pronat e komunës:

Më poshtë gjindet lista e pronave, të cilat janë përcaktuar me vendim të Kuvendit të Komunës që të jepen në shfrytëzim për personat fizik dhe juridik:

Nr	Zona Kadastrale	Numri i ngastrës	Sipërfaqja m ²	Vendi	Çmimi fillestar	Destinimi
2	Rekë	00156-0	5660 m ²	Rekë	0.08 m ²	Për biznes
3	Rekë	00105-0	930 m ²	Rekë	0.08 m ²	Për biznes
4	Rekë	00155-0	4596 m ²	Rekë	0.08 m ²	Për biznes
5	Kërbliq	00015-0	2843 m ²	Kërbliq	0.05 m ²	Për biznes
6	Kërbliq	00531-0	3336 m ²	Kërbliq	0.05 m ²	Për biznes

II. Kriteret për vlerësimin e ofertave:

- Vlera e çmimit të ofruar nga ofertuesi

III. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrsëve në ankandin publik

1 e drejte pjesemarrje dhe konkurimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës dhe investitorët e huaj.

IV. Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Fletë aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar
- Letërnjoftimi kopje
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit për bizneset (vendore)
- Dëshmi mbi përmbushjen e obligimeve ndaj komunës – tatimit në pronë, si dhe taksa komunale për bizneset komunale të ngarkuara;
- Dëshmi mbi numrin aktual të punësuarve (për bizneset ekzistuese)

V. Ankandi publik do të jetë i hapur për 30 ditë:

- Nga data 20.01.2017 deri më datë 20.02.2017 ora 14
- Ankandi publik do të jetë në ueb faqe të Komunës së Kaçanikut, në tabelën e shpalljeve të komunës dhe në një gazetë ditore
- Hapja publike e ofertave bëhet më datë 20.02.2017 në ora 14 në sallën e Kuvendit të Komunës

VI. Tërheqja e aplikacioneve në kopje fizike mund të bëhet në Qendrën për Shërbim me Qytetar, në hyrje të Komunës së Kaçanikut, çdo ditë pune prej 8.00 deri në ora 16.00 dhe të njejtat dorëzohen në zarf të mbyllur.

VII. Të interesuarit mund të informohen (çdo ditë pune) përmes:

- Ueb faqës - <http://kk.rks-gov.net/kacanik/>
- Tel 0290 46429
- Email burim.qaka@rks-gov.net

VIII. Tërheqja e aplikantëve nga ankandi publik, mund të bëhet jo më vonë se tri ditë para hapjes së ofertave.

Kryesuesi i Komisionit Vlerësues të Ofertave
Burim Çaka

